

Vendim nr. 221 datë 30.10.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 30.10.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (H) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HELIDON GJIKOKA**

OBJEKTI: **Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr.136, datë 21.06.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Helidon Gjikota, së bashku me disa shtetas të tjerë, janë akuzuar për kryerjen e disa veprave penale mbi bazën e dy kallëzimeve të shtetasit I.K. Në përfundim të hetimeve, Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vlorë kanë dërguar për gjykim çështjet penale në

ngarkim të tyre. Gjyqtari i seancës paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur dërgimin e akteve gjykatës kompetente, asaj të rrethit gjyqësor Vlorë, e cila e ka regjistruar çështjen në datën 08.07.2021. Me vendimin nr.10, datë 22.09.2021 të gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur bashkimi i çështjeve penale.

2. Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë (gjyqtari i seancës paraprake), me vendimin nr. 1282, datë 03.03.2022, për kërkuesin, ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 5670/2020. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurve Helidon Gjikokaj dhe A. K. për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”... Pavlefshmërinë absolute të vendimit, datë 07.04.2021 “Për sekuestrimin e sendeve” në lidhje me sekuestrimin (bllokimin) e objektit kompleks shërbimi me adresë: Gjilekë, Bashkia Himarë, zona kadastrale 1739, nr. Pasurie 300/301, sip. e parcelës ndërtimore 1353 m² sip. totale e ndërtimit 451 m² me pasojë shfuqizimin e tij. ... Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe detyrimin e saj për plotësimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. 5670/2020, sipas pjesës arsyetuese të vendimit. ... Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 1600 viti 2019 për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimit të detyrës”. Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 1600 viti 2019 ... Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe detyrimin e saj për plotësimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. 1600 viti 2019, sipas pjesës arsyetuese të vendimit ...”*. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kallëzuesi I.K., si dhe apel kundërshtues, ndër të tjerë, edhe kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 147, datë, 12.07.2022, ka vendosur: *“... Ndryshimin e vendimit të mësipërm për pjesën tjetër, në këtë mënyrë: Pranimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, në kuadër të procedimit penal nr.5670/2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të të pandehurve: 1. Helidon Gjikoka, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Mashtrimit" me pasoja të rënda e kryer në bashkëpunim dhe “Falsifikimi i vulave dhe stampave ose i formularëve e kryer në bashkëpunim”; ... Pranimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq në kuadër të procedimit penal nr. 1600/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në ngarkim të të pandehurve: ... 8. Helidon Gjikoka, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim. Shfuqizimin e vendimit të mësipërm për: Deklarimin të pavlefshëm të vendimit datë*

07.04.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për sekuestrimin e objektit kompleks shërbimi në Gjilekë Bashkia Himare, zk.1739, nr. pasurie 200/301, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 1353 m².”.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-469 (8), datë 16.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuesit dhe të shtetasve të tjerë, me argumentin se vendimi i gjykatës së apelit, i cili ka disponuar për dërgimin e çështjes në gjyq, bazuar në nenin 332/gj të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) nuk mund të ankimohet, për rrjedhojë kundër tij nuk mund të bëhet rekurs, sipas nenit 432 të po këtij kodi.

5. Në datën 20.04.2023 kërkuesi, së bashku me shtetasit e tjerë të akuzuar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual me objekt: “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 147, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2023-469 (8), datë 16.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Lënia në fuqi e vendimit nr. 1282, datë 03.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pezullimi i gjykimit të çështjes penale nr. 1282 të regjistrit themeltar, datë 03.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*”.

6. Me vendimin nr. 136, datë 21.06.2023 (*vendimi nr. 136/2023*), Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet e nevojshme juridike, pasi vendimi i gjykatës së apelit që ka disponuar për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të tij, për të cilin Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk mund të konsiderohet një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi jo vetëm që nuk vendos në mënyrë përfundimtare për fajësinë ose pafajësinë për kryerjen e veprave penale, por as nuk është provuar se ka ndonjë efekt të tillë cenes në të drejtat themelore të kërkuesit, të cilat nuk mund të mbrohen gjatë gjykimit në themel të çështjes.

7. Në datën 18.08.2023 kërkuesi i është drejtuar përsëri me kërkesë Gjykatës, sipas objektit. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuessit

8. *Kërkuessi* ka kërkuar saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 136/2023, pasi Kolegji i Gjykatës nuk është shprehur në lidhje me arsyet e mosshqyrtimit të pretendimit se masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive është vendosur në kundërshtim me nenin 274 të KPP-së, pavarësisht se e ka përfshirë atë në rubrikën “*Pretendimet e kërkuessit*”. Ky pretendim, sipas tij, nuk është marrë në shqyrtim as nga Gjykata e Lartë, e cila, duke e gjykuar çështjen në tërësi, ka vendosur mospranimin e rekursit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën nëpërmjet ankimit kushtetues individual kur pretendon se i janë cenuar liritë dhe të drejtat kushtetuese. Pika 1 e nenit 133 të Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se, fillimisht, çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për shqyrtim në seancë plenare.

10. Nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës shprehen qartësisht për forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, nenet 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë se vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Efekti detyrues i këtyre vendimeve ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në këtë pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë ajo (*shih vendimet nr. 11, datë 15.02.2018; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, vendimmarrja e Gjykatës nuk mund të bëhet objekt i kontrollit dhe nuk mund të vihet më në diskutim si nga kjo Gjykatë, ashtu dhe nga asnjë gjykatë brenda sistemit të brendshëm juridik.

11. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, rregullat e detajuara të procedurave të gjykimit kushtetues përcaktohen nga ligji nr. 8577/2000 dhe Rregullorja, të cilat në dispozita të posaçme kanë parashikuar kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjykimit kushtetues. Konkretisht, ligji nr. 8577/2000 parashikon: (a) rihapjen e procesit gjyqësor në rast të një vendimmarrjeje të mëparshme të saj, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit (*neni 71/c*); (b) saktësimin dhe plotësimin e vendimit, me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80*). Ky rregullim i fundit është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës Kushtetuese pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose të ndreqen gabimet në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në të. Sipas këtyre dispozitave kërkesa paraqitet brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.

12. Referuar kërkesës në shqyrtim, rezulton se kërkuesi në objektin e saj ka kërkuar saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 136/2023 të Kolegjit, ndërkohë që, referuar shkaqeve të saj, pretendohet se në vendim nuk i është kthyer përgjigje pretendimit të paraqitur në kërkesën e datës 20.04.2023 për kundërshtimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive. Sipas kërkuetit, megjithëse ky pretendim ka qenë edhe një ndër shkaqet e rekursit, as Gjykata e Lartë nuk është shprehur lidhur me ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatës së apelit, e cila ka shfuqizuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për deklarin e pavlefshëm të vendimit të prokurorisë për vendosjen e sekuestros preventive të objektit kompleks shërbimi në pronësi të tij.

13. Për rrjedhojë, në rastin konkret, dukshëm nuk jemi përpara asnjë prej rasteve që ligji e legjitimon kërkuetin për t'iu drejtuar Gjykatës me kërkesë për kundërshtimin e vendimeve të saj dhe që lejojnë saktësimin ose plotësimin e tyre, për sa kohë që ai në thelb kërkon rishikimin e vendimit të Kolegjit, duke marrë në shqyrtim, sipas tij, pretendime që janë ngritur në rekurs dhe në ankimin kushtetues individual, por që nuk kanë gjetur trajtim dhe arsyetim.

14. Kolegji konstaton se, për sa i takon procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë në lidhje me kërkuetin ka disponuar me pranimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq për kryerjen nga ai në bashkëpunim me

shtetasit e tjerë të disa veprave penale, si dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pjesën në të cilën ka deklaruar të pavlefshëm vendimin e datës 07.04.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për vendosjen e sekuestros preventive të objektit kompleks shërbimi në Gjilekë, Bashkia Himarë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-469 (8), datë 16.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuarit dhe të shtetasve të tjerë, me arsyetimin se, bazuar në dispozitat procedurale penale, vendimi i gjykatës së apelit nuk mund të ankimohet.

15. Në kërkesën e datës 20.04.2023, për të cilën është dhënë vendimi i Kolegjit nr. 136/2023, kërkuari ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore nr. 147, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 00-2023-469 (8), datë 16.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1282, datë 03.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së ankimit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të sigurisë juridike, së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit, standardit të arsytimit dhe së drejtës së pronës. Në lidhje me sekuestron preventive ai ka pretenduar se Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur masën e sigurimit "sekuestro preventive" ndaj pasurisë së tij, pa kërkesë të prokurorisë, shkelje e cila nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

16. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës së kërkuarit, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 136/2023, mbështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, ka konstatuar se vendimi gjyqësor që ka si objekt dërgimin në gjyq të çështjes, nuk mund të konsiderohet një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi jo vetëm që nuk vendos në mënyrë përfundimtare për fajësinë ose pafajësinë për kryerjen e veprave penale, për të cilat kërkuari akuzohet, por as nuk është provuar se ka ndonjë efekt të tillë cenes në të drejtat themelore të tij, të cilat nuk mund të mbrohen gjatë gjykimit në themel të çështjes. Ai ka vlerësuar se në rastin konkret nuk jemi përpara rasteve përjashtimore që lejojnë përfshirjen në juridiksionin kushtetues edhe të vendimeve gjyqësore të ndërmjetme. Në përfundim të shqyrtimit të plotësisht të kriterëve paraprake të pranueshmërisë, Kolegji ka vendosur moskalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkuari nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion (*shih paragrafin 17 të vendimit nr.136/2023 të Kolegjit*).

17. Për rrjedhojë, për sa kohë që Kolegji ka vlerësuar se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion lidhur me pretendimin në tërësi për vendimin e dërgimit të çështjes në gjyq, kjo nënkupton se ai ka mjete të tjera ligjore në dispozicion për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij edhe për masën e sekuestros preventive gjatë procesit gjyqësor që do të shqyrtojë në themel çështjen penale. Në kuptim të parimit të subsidiaritetit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të shprehën për pretendimet për cenimin e të drejtave gjatë procedurave penale përpara se të vihet në lëvizje juridiksioni kushtetues, përfshirë edhe çdo pretendim që lidhet me ligjshmërinë ose vlefshmërinë e akteve procedurale të marra në fazën e hetimeve paraprake. Në këtë kuptim, shqyrtimi paraprak i Kolegjit, në përfundim të të cilit është dhënë vendimi nr. 136/2023, është ndalur në vlerësimin në tërësi të natyrës së procesit të kundërshtuar dhe nuk ka disponuar asnjë vlerësim mbi argumentet e paraqitura nga kërkuesi.

18. Për sa më lart, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 136/2023, i ka dhënë përgjigje shteruese kërkuesit në lidhje me përmbushjen e kriterëve paraprake të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577/2000.

19. Në vështrim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të mësipërme, si dhe rrethanave faktike, Kolegji vëren se kërkuesi nuk gjendet në asnjë nga situatat e parashikuara nga neni 80 i ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 43 i Rregullores, për rrjedhojë nuk ka vend për plotësimin, saktësimin ose ndreqjen e pasaktësive në vendimin nr.136/2023 të Kolegjit të Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 31, 31/a, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.